



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit SHSKUK OE ankues "Rona Farm"	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Ilir Halili – Ekspert profesional shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.306/19 të parashtruar nga OE "Rona Farm" shpk-Prishtinë		
Datë	25.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 15.06.2019, me nr.306/19 të parashtruar nga OE **"Rona Farm"** shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me citostatik nga LE për nevojat e SHSKUK"**, me numër të prokurimit: **220/19/2031/1/1/1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **SHSKUK**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SHSKUK**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**.
- OE ankues – **"Rona Farm" shpk- Prishtinë**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI i EKSPERTIT SHQYRTUES

	17.06.2019	25.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 15.05.2019 OE "Rona Farm" shpk-Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, me nr. 306/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me citostatik nga LE për nevojat e SHSKUK", me numër të prokurimit: 220/19/2031/1/1/1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Dispozitat e shkelura sipas Operatori Ekonomik ankues "Rona Farm"- Prishtinë

Neni 1
Neni 6
Neni 7
Neni 59
Neni 60

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Neni 1

AK ka për obligim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, e që në rastin konkret ka dështuar të përmbushë një dispozitë të tillë ligjore, pasi që në vend që të p[aguaj vlerën e furnizimit 85,833.33 euro, ka shpërblyer operatorin ekonomik "Exkluzive Corporation" shpk, me çmim më të lartë, por do ta sqarojmë në vijim se në këtë produkt nuk aplikohet TVSH-ja andaj edhe pse ne kemi aplikuar normën e TVSH-së, AK ka pas për detyrim ligjor që normën e TVSH-së prej 8% të mos e përfshij në çmimin përfundimtar. Ne kemi aplikuar për faktin se vet AK tek lista e cmimeve ka futur kolonën e TVSH-së, por vet fakti ti se rap[orati i hapjes publike përmban cmimin pa dhe me TVSH atherë AK ka pas per obligim qe ne kuptim të nenit 7 te na trajtoj në mënyrë identike apo të barbartë me operatorët tjerë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Rona Farm" shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me citostatik nga LE për SHSKUK", me numër të prokurimit: 220-19-2031-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

Neni 7

Duke pas për bazë këtë nen AK ka për obligim që të gjithë OE pjesëmarrës ti trajtoj në mënyrë të barbartë dhe në rastin konkret ka qenë e domosdoshme që në kuptim të këtij neni të merren për bazë cmimet pa TVSH, pasi që nuk mund të trajtoj cmimin e një OE me TVSH, ndërsa cmimin e OE tjerë pa TVSH, dhe kjo shihet edhe në raportin e hapjes publike.

Neni 59

Ne kemi kaluar të gjitha fazat e vlerësimit por arsyetimi nga AK ka qenë se ne nuk kemi ofruar cmimin më të ulët se sa OE I rekomanduar për kontratë, por ky arsyetim është I pa qëndrueshëm për arsye se cmimi jonë në raport me OE të rekomanduar ka një diferencë prej 4,166.67 euro, por natyrisht kur kalkulojmë normën 8% atëherë cmimi rezulton të jetë më I lartë, por në këtë rast normën prej 8% duhet minusuar, pasi që është në kundërshtim me ligjin për TVSH, pasi që në faturim nuk kemi të drejtë të aplikojmë normën e TVSH-së që do të thotë se cmimi ynë përfundimtar është më I lirë se sa I OE të rekomanduar për kontratë.

Sa për informimin tuaj ne jju kemi referuar interpretimeve të KRPP-së dhe vendimeve të OSHP ku situata është e njëjtë sikurse në rastin konkret që përgjigja e KRPP tek pyetjet e shpeshta është si në vijim:

Pyetja nr.46. Interpretim i i KRPP thotë (citim) : Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Gjithashtu sipas Doganave e Kosovës e cila deklaron se ky produkt nuk I nënshtrohet TVSH-së dhe interpretimit të KRPP nr.46 korrigjimi I TVSH-së nmuk llogaritet gabim aritmetik.

Ofertuesit tjerë kanë TVSH-në 0%, kurse ne kemi kalkuluar TVSH-8%, pasi që vet AK tek lista e cmimeve e ka shënuar cmimin me TVSH dhe cmimin pa TVSH.

Duke u thirrur në interpretimin e KRPP dhe në disa vendime të OSHP-së konkretisht në vendimin 125/17, ju si AK ofertës sonë duhet hekur përqëndjen e TVSH-së , pasi që është oferta me cmimin më të lirë. Pra , të trajtohem i njëjtë me OE tjerë nga aspekti I cmimit pasi që gabimi është vetëm në normën e TVSH-së, pra oferta bie më e lirë se cmimi I ofertës së rekomanduar për kontratë.

Për më tepër I referoheni pyetjes nr.46 të publikuar në linkun “Ndihmesë” te puetjket e shpeshta ku intepretim nr.46 thotë (citim): Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë. Pra bazuar në këtë interpretim AK duhet të korrigjoj cmimin lidhur me TVSH, pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë, sepse vet tatimi mbi vlerën shtuar nuk është tatim i OE, por tatim i konsumatorit, andaj ju si AK keni për obligim që për kontratë të merrni për abzë cmimin pa TVSH.

Neni 60

Duke I marr për bazë sqarimet e lartcekuru ju i AK keni detyrim që tu përmbaheni kriterit të përcaktuar për vlerësim, e që në rastin kont.ret kriteri vlerësim i ka qenë tenderi i për gjegjshëm me cmim më të ulët.

Pra nuk është etike dhe as I i gjore që për një produkt apo shërbim të njëjtë të paguani më shumë duke u thirrur në justifikimin se cmimi ynë është më I lartë se sa OE I rekomanduar sepse e cekëm që në fillim se ne kuptim te nenit 7 të LPP-së keni për obligim ir që OE pjesëmarrësë ti trajtoni në mënyrë të barabartë dhe konkretisht në vlerësim

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Rona Farm”shpë-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit“Furnizim me citostatik nga LE për SHSKUK”, me numër të prokurimit: 220-19-2031-I-1-I, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

përfundimtar krahasimi I cmimeve duhet të bëhet pa normën e TVSGH-së prej 8% pasi që produkti në fjalë është I liruar.

Provë pyetja 46. *Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?*

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

AK në vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim mundohet që TVSH ta trajtoj si gabim aritmetik, dhe kjo bie në kundërshtim me paragrafin e cekur më lartë për vet faktin se aty thuhet se korrigjohet madje pa pyetur OE, dhe asnjë formë nuk kemi të bëjmë me gabime të tilla pasi që gabimet aritmetike janë kur nuk përputhet cmim X njësisia e në rastin konkret kemi të bëjmë me normë tatimore, ku edhe vet AK në listën e cmimeve e ka përfshirë kolonën për TVSH, pra një asnjë fomë nuk kemi të bëjmë me gabim aritmetik.

Subjektivizmi I AK-së shihet shumë qartë lidhur me përgjigjen që ka të bëjë me kërkesën për rishqyrtim për faktin se thotë se ne kemi qenë I njoftuar me aplikimin apo mos aplikimin e TVSH, por që në kërkesën për rishqyrtim kemi shpresuar në korrigjimin e vebndimit pasi që ju pas ankesës-kërkesës sinë jus i AK keni kërkuar nga ne që të ofrojmë dëshmi se produkti në fjalë ka qenë I liruar, dhe pas sjelljes së dëshmive ju na keni eliminuar me arsyetim se ne kemi qenë të njoftuar, por duhjet kuptuar se ne edhe sikur të kishim ditur detyrimisht cmimin nuk do guxonim a faturonim me TVSH sepse një gjë e tillë nuk e lejojnë ligji për TVSH dhe kodi doganor, pasi që produktet e tilla janë të liruar, dhe gabimi ka qenë nga ana jonë por është gabim që lejon ligji ta korrigjoni pa konsideruar asnjë lloj shkelje ligjore, pasi që keni të bën I me një cmim më të lirë për furnizim.

Infotrimi I AK shihet në paragrafin e gfuindit të vendimit ku AK pretendon se ne jemi munduar ta qesim në lajthitje AK, dhe për ne është e paqartë se për qfar lajthitje bëhet fjalë pasi që oferta jonë është përmes E-Prokurimit dhe oferta është mëse e qartë por ne kemi kërkuar të bëhjet korrigjimi I nevojshëm pasi që një gjë e tillë e lejon rregullat dhe udhëzimet e KRPP, madje për këtë kemi marrë edhe vebndimet e OSHP-së konkretisht vendimet 157/17 që pikërisht ka të bëjë me situatën e njëjtë dhe jkemi analizuar njoftimin për Kuvendin Komunal Gjakovë për tenderin me nr.ref.632/17/057/121, ku pikërisht AK fillimisht e ka eliminuar OE sepse për pajisje bujqësore ka vendosur normën e TVSH për një produkt për të cilin në fakt nuk është dashur të aplikohet norma pasi që pajisjet bujqëdore janë të liruara nga aplikimi I TVSH-së.

Ne kemi një situatë të njëjtë sikurse në vendimet dhe interpretimet e cekura më lartë, andaj kërkojmë nga OSHP të aprovoj ankesën tonë të bazuar dhe aktivitetin e prokurimit "Furnizim me citostatik nga LE për SHSKUK" ta kthejë në Rivlerësim pasi që përveq neve që na shkakton humbje njëkohësisht pasoja do ti bartë edhe vet SHSKUK-ja pasi që sipas rekomandimit të tyre obligohet që të paguaj më shtrenjtë duke u thirrur në justifikime të paqëndrueshme dhe të pabazuara sepse nuk kemi të bëjmë me korrigjime aritmetike, që është krejtësisht e kundërligjshme madje konsiderohet sajim I fakteve nga AK me të vetmin qëllim që të shpërblejë OE të caktuar.

Dëmet Materiale

Dëmet së pari janë për vet AK, por si duket paraja publike nuk ju bënë përshtypje pasi që sikur blerjen ta bënin me para personale do të pranonin qdo lloj gabimi në mënyrë që të kursenin paratë por si duket dhe me këtë shihet qartë favorizimi respektivisht diskriminimi i AK-së për marrje të vendimit Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

Njëkohësisht dëmi është i pakontestueshëm edhe për ne, por shpresojmë në vendim meritot të OSHP-së përmes së cilit do të trajtohet në mënyrë të drejtë ankesën tonë, pasi që konsiderojmë se gjitha faktet dhe procat e prezantuara janë në anën tonë.

Shënim: Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesen e deponuar nga OE ankuese ne OSHP, jane te njëjta me ato të paraqitura me kërkesen për rishqyrtim nga OE ankuese në AK.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:10.04.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë publike -kornizë/ vlerë e madhe

Vlera e parashikuar e kontratës **523,080.00 €**

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....08.05.2019

Data e hapjes së ofertave.....08.05.2018

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave..... 27.05.2018

Data e njoftimit me letrën standarde 31.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim..... 03.06.2018

Data e vendimit nga AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim..... 08.06.2019

Kriteret për vlerësim:

Çmimi më i ulët.

Vlera e parashikuar	2.6	<div>LOT 1. 110,700.00 €</div> <div>LOT 2. 46,080.00 €</div> <div>LOT 3. 13,884.00 €</div> <div>LOT 4. 40,044.00 €</div> <div>LOT 5. 50,340.00 €</div> <div>LOT 6. 53,892.00 €</div> <div>LOT 7. 100,500.00 €</div> <div>LOT 8. 67,680.00 €</div> <div>LOT 9. 18,000.00 €</div> <div>LOT 10. 21,960.00 €</div> <div>TOTALI I LOTVE: 523,080.00 €</div>	
		<div>Kërkesat e përshtatshmërisë:</div> <div>Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligji të Prokurimit Publik (LPP).</div>	<div>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</div> <div>Evidenca 1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit QKUK ka</div>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE "Rona Farm"shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit"Furnizim me citostatik nga L.E për SHSKUK", me numër të prokurimit: 220-19-2031-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

			<p>ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të QKUK, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit të ofertës dhe QKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë. Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon</p> <p>a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. (kopje).</p>
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<p>Përshtatshmëria profesionale</p> <p>Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit , regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit si dhe me informacione të biznesit-Kopje</p>
		<p>Kërkesa 2. Certifikatë e numrit fiskal .</p>	<p>Evidenca 2. Te dëshmohet me Certifikatë të Numrit Fiskal-Kopje</p>
		<p>Kërkesa 3. Certifikatë e</p>	<p>Evidenca 3. Te dëshmohet me</p>

		TVSh-së. Kërkesa 4. Liçencë valide nga AKPM si qarkullues me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale (me validitet).	Certifikatë te TVSh-së Kopje. Evidenca 4. Te dëshmohet se OE është i regjistruar ne AKPM si qarkullues me shumice për produkte dhe pajisje medicinale (me validitet)- Kopje.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 1. Autorizim nga prodhuesi për pjesëmarrje në këtë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesit. Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi-dileri, kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi. Kërkesa 2. Të dëshmohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me dozën e produktit të kërkuar.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1. Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje ne këtë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi (me te dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, ëeb faqja etj, për mundësi te verifikimit). Ne rast te autorizimit nga përfaqësuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi Evidenca 2. Autorizimi për Marketing ne Kosove, nga AKPPM sipas UA 01 2015, me dozën e produkteve te kërkuar.
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	
Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: 90 ditë,	
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	24.1	Afati i fundit për dorëzim është 08.05.2019 , në 13:00:00 orë Vendi: SHSKUK, zyra nr. 28	
Afati kohor për dorëzimin është shkurtuar		Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar: Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nëse po, jep arsytim:	
Hapja e Tenderit	27.1	Hapja e tenderit do te bëhet me: 08.05.2019 në 13:00:00 orë Vendi: SHSKUK, zyra nr. 28	
	30.3		
Kriteret e Dhënies	31.1	[Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët] <input checked="" type="checkbox"/> apo	
Ankesat	32.3	Shëno adresën e AK-së.	

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE "Rona Farm" shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me citostatik nga LE për SHSKUK", me numër të prokurimit: 220-19-2031-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:		Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru		Furnizim me citostatik nga LE për nevojat e SHSKUK-së			
Numri i brendshëm Internal No Interni broj		220 19 011 111					
Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera			
08.05.2019	08.05.2019, 13:00:00	08.05.2019, 13:00:00	SHSKUK, zyra nr. 28	7			
Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Supplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	"EXCLUSIVE CORPORATION" SH.P.K., Hilmi Rakovica Nr 43, 10000, Prishtine	1109	LOT 1	PO	90000,00	90000,00	JO
2.	"Agani L.t.d" Sh.p.k., Magj. Prishtine-Ferizaj, Km.5 Graçanice, 10000, PRISHTINE	Oferta Nr. 23/19/F	LOT 1	PO	195000,00	195000,00	JO
3.	"MEDITECH" SH.P.K., e Livadhut Çagllavicë, 10000, PRISHTINË	007/2019	LOT 2	PO	45720,00	45720,00	JO
4.	"MEDITECH" SH.P.K., e Livadhut Çagllavicë, 10000, PRISHTINË	007/2019	LOT 6	PO	53856,00	53856,00	JO
5.	"Liri - Med" SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 80, - 10000, PRISHTINË	LM13-00220-19-2031-111	LOT 1	PO	330000,00	330000,00	JO
6.	"Liri - Med" SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 80, - 10000, PRISHTINË	LM13-00220-19-2031-111	LOT 4	PO	40044,00	40044,00	JO
7.	"Liri - Med" SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 80, - 10000, PRISHTINË	LM13-00220-19-2031-111	LOT 5	PO	110640,00	110640,00	JO

B12_ PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE "Rona Farm" shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me citostatik nga LE për SHSKUK", me numër të prokurimit: 220-19-2031-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

8.	" Liri - Med " SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 80, - 10000, PRISHTINË	LM13-00220-19-2031- 111	LOT 8	PO	104400,00	104400,00	JO
9.	" Liri - Med " SH.P.K., Agim Ramadani Nr. 80, - 10000, PRISHTINË	LM13-00220-19-2031- 111	LOT 9	PO	33600,00	33600,00	JO
10.	„Santefarm“ Sh.p.k., MAGJISTRALA PRISHTINË FERIZAJ KM.8, - GRACANICA	00220-19-2031-111	LOT 3	PO	12480,00	12480,00	JO
11.	„Santefarm“ Sh.p.k., MAGJISTRALA PRISHTINË FERIZAJ KM.8, - GRACANICA	00220-19-2031-111	LOT 7	PO	100500,00	100500,00	JO
12.	N.T.P. " ICN & BM ", NDUE PERLESHI ,P.N., 10000, PRISHTINË	citostatik Maj 2019	LOT 7	PO	90000,00	97500,00	JO
13.	" Rona Farm " Sh.p.k., Rr. Shefqet Shkupi pn, B- Lagjia Kalabria, 10000, Prishtine	01-05/2019	LOT 1	PO	85833,33	92700,00	JO

B12_ PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për rivlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

Zenel Kuqi – Kryetar i komisionit

Faton Sermaxhaj – Anëtar i komisionit

Behar Raci – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Rona Farm" shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me citostatik nga LE për SHSKUK", me numër të prokurimit: 220-19-2031-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SHSKUK.

Komisioni për vlerësimin e ofertave në bazë të kriterëve në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit, dhe kriterëve për dhënie për kontratë propozon OE të përgjegjshëm me cmimin më të lirë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Rona Farm" shpk-Prishtinë

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor (dhe i vetëm) ankimorë në rastin konkret është se AK-SHSKUK gjatë vlerësimit të ofertave është dashtë të bëjë korrigjimin e normës së të TVSH të dhënë nga OE ankues në këtë rast prej 8%.

OE ankues pretendon se në rastin konkret për produktin "Imantinib" nuk aplikohet TVSH.

Ky pretendim ankimorë është i bazuar, dhe duke ju referuar Pyetjes dhe përgjigjes nr.46 të KRPP-së, Autoriteti Kontraktues ka qenë dhe është i obliguar që të bëjë korrigjimin e normës së TVSH-së pa kërkuar sqarime tjera nga OE-të.

Në rastin konkret AK do duhej të bëjë korrigjimin e normës së TVSH-së dhe të vazhdoj me vlerësim të mëtutjeshër e ofertave.

Duke ju përgjigjur pretendimit të OE ankues, dhe për sqarim të autoritetit kontraktues, OSHP ka shqyrtuar rastet shumë ku ka trajtuar pikërisht këtë problem, i cili është identik me rastin konkret, korrigjimin dhe aplikimin e normës së duhur të TVSH-së nga ana e AK-së.

Më poshtë gjeni pyetjen dhe përgjigjen e KRPP-së lidhur me korrigjimin e normës së aplikueshme të TVSH-së, kështu përgjigja e KRPP-së është mjaft e qartë se si duhet vepruar në ato raste.

46. Si të vepohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më ulët se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkojë sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjet në pretendimet ankimore), ndërsa rekomandon që anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.